



# Sfidat në dhënien e subvencioneve nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe digjitalizimi si instrument për ritjen e efikasitetit

Projekti "Mbështetje për Shoqërinë Civile për të Rritur Mbikëqyrjen Publike dhe Llogaridhënien e Institucioneve Publike të Kosovës" financohet nga Ministria e Punëve të Jashtme, Komonuelthit dhe Zhvillimit të Mbretërisë së Bashkuar përmes Ambasadës Britanike në Prishtinë.

Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi vetëm e Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), Instituti GAP (GAP) dhe Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Komonuelthit dhe Zhvillimit të Mbretërisë së Bashkuar.



British Embassy  
Pristina



Group for Legal  
and Political  
Studies



INSTITUTI GAP  
GAP INSTITUTE



# Sfidat në dhënien e subvencioneve nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe digjitalizimi si instrument për rritjen e efikasitetit

## Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	4
Hyrje	5
Sfidat në procesin e ndarjes së subvencioneve në MKRS dhe digjitalizimi si zgjidhje e tyre	7
Praktikat e shpërndarjes së subvencioneve në vendet e Bashkimit Evropian	10
Modeli për Kosovën dhe rekomandime	12
Përfundim	14
Aneks	15

# Përmbledhje ekzekutive

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) është një ndër ministritë me buxhetin më të madh të ndarë për grante dhe subvencione, me rreth 38 përqind të gjithëj buxhetit të përgjithshëm të saj të dedikuar për kategorinë e subvencioneve dhe transfereve. Ndër vite, janë hapur thirrje të shumta për subvencionim në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, për kategorinë e individëve dhe organizatave jo-qeveritare. Megjithatë, procesi i ndarjes së këtyre fondeve, duke filluar nga faza e hapjes së thirrjeve e deri në përmbylljen e projekteve, ka shfaqur sfida të ndryshme përgjatë viteve. Këto sfida kanë pasur ndikim në efikasitetin dhe efektivitetin e subvencioneve kundrejt përmbushjes së përgjithshme të objektivave strategjike të MKRS. Deri më tani, aplikimet në thirrjet e hapura bëhen përmes dorëzimit fizik të dokumenteve ose përmes e-mailit. Si zgjidhje e duhur në këtë situatë është digjitalizimi i procesit të dhënies së granteve dhe subvencioneve nga MKRS. Në vitin 2022, MKRS kishte tentuar që ta digjitalizojë procesin e aplikimit, mirëpo ishin paraqitur probleme si mos-funksionimi i sistemit online për aplikim, e që si pasojë ka shkaktuar vonesa në aplikim dhe në vlerësim, mungesë të transparencës, në disa raste humbje të dosjeve/dokumenteve, kërkesa për dokumentacion origjinal nga MKRS, si dhe mos-mbyllje të avanseve dhe projekteve.

Në këtë raport janë analizuar 51 thirrje të hapura nga MKRS gjatë një periudhe tre vjeçare (2021-2023), dhe bazuar në të dhe në përvojat e aplikuesve/përfituesve, janë identifikuar disa sfida në procesin aktual të dhënies së granteve dhe subvencioneve. Fillimisht, është llogaritur që koha e vlerësimit të aplikuesve nga momenti i mbylljes së thirrjeve e deri tek shpallja e fituesve, është 48.8 ditë biznesi. Ndërsa, ligjërisht është e përcaktuar se kjo duhet të ndodhë për 15 ditë. Sfidat tjera që janë identifikuar në këtë proces janë: objektiva të thirrjeve që janë sipërfaqësore dhe të përgjithshme, mos-përputhje të karakteristikave të përfituesve me kriteret e thirrjes, mungesa e transparencës gjatë proceseve të vlerësimit, etj. Në fazën e zbatimit dhe monitorimit të projekteve përfituese, problemet kryesore janë vonesat në nënshkrimin e kontratave, e që rrjedhimisht ndikojnë në realizimin e projekteve, si dhe mungesa e monitorimit të zbatimit të projektve për shkak të mungesës së burimeve njerëzore të MKRS. Konkretisht, nga aspekti i numrit të të punësuarve në departamentet përkatëse në MKRS, dhe numri i subvencioneve të ndara për tre vite, është llogaritur që një zyrtar mesatarisht të monitorojë zbatimin e dhjetë projekteve në vit.

Sipas gjetjeve të kësaj analize, shihet qartë që digjitalizimi i gjithë procesit të ndarjes së granteve dhe subvencioneve është i domosdoshëm, duke filluar nga faza e hapjes së thirrjes e deri në përmbylljen e projektit. Përmes një platforme digjitale, do të rritej transparenca dhe llogaridhënia në proceset e ndarjes së subvencioneve, si dhe këto procese do të bëheshin më efikase dhe efektive, duke kursyer në kohë dhe kosto financiare. Të gjitha sfidat e përmendura më lartë, mund të adresoheshin lehtësisht përmes përdorimit të një sistemi digjital. Aplikuesit do të ngarkonin të gjitha dokumentet online, duke mos pasur kosto të aplikimit, si dhe MKRS do të bënte një vlerësim më efikas, duke i pasur të gjitha dokumentet në verzion digjital në një vend. Për më shumë, do të krijoheshin historiku për të gjithë aplikuesit, e që i lehtëson procedurat e aplikimit në thirrjet e ardhshme. Sistemi automatikisht do të mund të kryente këtë funksion përmes interoperabilitetit me regjistra të tjerë shtetëror (përfshirë këtu ATK, ARBK, regjistrin civil, të dhënat e komunave, etj). Tutje, marrë parasysh sfidat dhe mungesën e kapaciteteve njerëzore në monitorimin e zbatimit të projekteve, digjitalizimi do të lehtësonte procesin e monitorimit, duke mundësuar që aktivitetet e zhvillimit të projekteve përfituese të dokumentoheshin përmes fotove/videove dhe të ngarkoheshin në sistem, pa pasur nevojë që të gjitha të monitorohen në terren.

# Hyrje

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), si një ndër ministritë me buxhetin më të madh për grante dhe subvencione, ka disa instrumente të financimit të aktiviteteve kulturore, artistike dhe sportive. Në vitin 2023, MKRS u radhit pas Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR) për nga shuma e dedikuar për subvencione dhe transfere, duke arritur vlerën prej 22 milionë euro.<sup>1</sup> Ndër vite, ka pasur rritje të vazhdueshme të buxhetit të subvencioneve në të gjitha fushat si sporti, kultura e trashëgimia kulturore, përveç në fushën e rinisë që në disa vite ka pasur rënie. Nëse analizohet si përqindje e gjithsej buxhetit të MKRS, del se rreth 38 përqind e buxhetit të kësaj ministrie është dedikuar për kategorinë e subvencioneve dhe transfereve.<sup>2</sup> Në aspekt të realizimit të buxhetit për këtë kategori, vërehet një përqindje relativisht e lartë për një periudhë dhjetë vjeçare, duke variuar nga 88 përqind në vitin 2013 deri në 99 përqind në vitin 2023 (për më shumë shih Tabelën 1 në Aneks).<sup>3</sup> Rritja e buxhetit për subvencione në MKRS tregon përpjekje të vazhdueshme për të përmirësuar mbështetjen dhe zhvillimin e sektorëve të kulturës, rinisë, sportit dhe trashëgimisë kulturore në Kosovë.

Shumica e thirrjeve të hapura për subvencionim të projekteve për individë dhe organizata jo-qeveritare (OJQ) në MKRS bazohen në një strategji apo objektiv strategjik, program të miratuar, plan të punës të departamenteve përkatëse, apo edhe vendime të Qeverisë/Ministrave. MKRS ka dy strategji të miratuara siç janë Strategjia për Trashëgimi Kulturore 2017-2027 dhe Strategjia Shtetërore për Rini 2024-2032. Në këtë raport, janë analizuar gjithsej 51 thirrje të hapura publike të MKRS-së gjatë periudhës 2021-2023. Shumica e këtyre thirrjeve janë bazuar në dy strategjitë<sup>4</sup> e përmendura më lartë, ndërsa shtatë prej tyre nuk bazohen në ndonjë strategji të caktuar. Përveç strategjive, thirrjet e MKRS-së janë bazuar edhe në vendime të Qeverisë dhe Pakos së Rimëkëmbjes/Ringjalljes Ekonomike (kjo e fundit ishte më e shprehur gjatë periudhës së pandemisë Covid-19). Në aspekt ligjor, MKRS në ndarjen e subvencioneve bazohet në Rregulloren e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve<sup>5</sup>, si dhe Rregulloren e brendshme për subvencionim në fushën e kulturës, trashëgimisë kulturore, rinisë dhe sportit<sup>6</sup>. Në bazë të këtyre rregulloreve, bëhet edhe përcaktimi i mënyrës së aplikimit (përfshirë këtu edhe mostrat e formularëve për aplikim), periudha dhe mënyra e vlerësimit të projekteve (përmbajtja e komisioneve, afatet kohore të vlerësimit dhe procedurat), si dhe përgjegjësitë e institucionit në monitorimin e zbatimit të projekteve të subvencionuara (procesi i detajuar i monitorimit të projekteve nga zyrtarët e MKRS-së).

<sup>1</sup> Kjo vlerë paraqet buxhetin në SIMFK të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, dhe dallon me vlerën fillestare të buxhetuar.

<sup>2</sup> Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. [Raporti vjetor financiar për vitin 2023, Buxheti i Republikës së Kosovës](#). Dhjetor 2023. Hapur së fundmi më 20 qershor 2024.

<sup>3</sup> Raportet vjetore financiare të Ministrisë së Financave, 2013-2023. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

<sup>4</sup> Në këtë rast, meqë thirrjet e analizuar janë deri në vitin 2023, ato janë bazuar në strategjinë e vjetër për rini (Strategjia për Rini 2019-2023).

<sup>5</sup> Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. [Rregullore nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve](#). Hapur së fundmi më 8 qershor 2024.

<sup>6</sup> Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. [Rregullore nr. 09/2015 për subvencionim në fushën e kulturës, trashëgimisë kulturore, rinisë dhe sportit](#). Hapur së fundmi më 8 qershor 2024

Gjatë periudhës 2021-2023, MKRS ka mbështetur 2,399 projekte në vlerë prej 17 milionë euro për OJQ dhe individë në tri fusha kryesore: kulturë, rini dhe sport.<sup>7</sup> Për shkak të mangësive të thirrjeve nga aspekti i shpalesjes së planifikimeve buxhetore për secilën thirrje, është e vështirë të bëhet një matje e saktë në mes të buxhetit të planifikuar për thirrjet përkatëse dhe buxhetit të shpenzuar për to. Në shumë raste ka pasur publikim të listave të përfituesve të shpallura në të cilat mungojnë shumat financiare të ndara, derisa janë paraqitur vetëm pikët e individëve/OJQ-ve fituese të projekteve. Ndërsa, për shumicën e projekteve të mbështura është e vështirë të matet efektiviteti i parasë së ndarë nga MKRS. Ndonëse, për disa projekte specifike, si Dokufest<sup>8</sup> apo Manifesta<sup>9</sup>, Instituti GAP ka bërë vlerësime të ndikimit ekonomik të tyre, si dhe kthimin e mjeteve nga fondet publike.

Megjithatë, në MKRS, ndër vite janë shfaqur sfida në faza të ndryshme të këtyre proceseve. Disa nga sfidat që janë përmendur nga përvojat e aplikuesve<sup>10</sup> për subvencione si dhe edhe nga Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA)<sup>11</sup> përfshijnë mos-funksionimin e sistemit online për aplikim të MKRS si dhe platformës e-Kosova, humbjen e dosjeve/dokumenteve të aplikuesve nga MKRS, mungesën e transparencës gjatë proceseve të vlerësimit, neglizhencën nga MKRS në mbylljen e avanseve nga përfituesit, kapacitetet e ulëta të MKRS në monitorimin e zbatimit të projekteve, dhe të tjera. Tutje, gjatë procesit të vlerësimit nga thirrjet e analizuara në këtë raport është vërejtur që ka vonesa në vlerësim, ndonëse afatet janë të përcaktuara sipas rregulloreve përkatëse. Për më shumë, edhe në fazën e monitorimit janë vërejtur parregullsi, ku sipas raporteve të ZKA-së, gjatë periudhës 2008-2014, ishin rreth gjashtë milionë euro avanse/projekte të pa mbyllura nga MKRS. Gjithashtu, kishte raste edhe kur disa OJQ kishin përfituar subvencionim të dyfishtë nga dy departamente brenda Minsitrisë.<sup>12</sup>

Rrjedhimisht, në mënyrë që të thjeshtësohet procesi i ndarjes së subvencioneve, si dhe të evitohen sfidat e përmendura më lartë, është vërejtur nevoja për digjitalizim të gjithë këtij procesi. Pra, në mënyrë që të evitohen problemet si humbja e dokumenteve, mungesa e historikut të përfituesve, mbyllja e avanseve, vonesat në vlerësim apo në adresim të ankesave, konsiderohet se kalimi i këtij procesi në një platformë digjitale, duke filluar nga aplikimi tek vlerësimi dhe monitorimi i zbatimit të projekteve, është shumë i nevojshëm. Tutje, përveç aspektit ligjor, nevoja për digjitalizim gjithëpërfshirës të shërbimeve administrative për qytetarët e Kosovës parashihet edhe në vizionin politik të qeverisë.<sup>13</sup> Lidhur me digjitalizimin e proceseve të ndarjes së subvencioneve, nuk ka pasur ndërrim të bazës ligjore, mirëpo ato janë paraparë në Rregulloren e MFPT mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.<sup>14</sup>

<sup>7</sup> Llogaritje nga GAP bazuar në databazën e mbledhur të thirrjeve të publikuara për vitet 2021-2023.

<sup>8</sup> Instituti GAP. [Ndikimi ekonomik i Dokufest 2023](#). Shkurt, 2024. Hapur së fundmi më 1 korrik 2024.

<sup>9</sup> Instituti GAP. [Manifesta 14, Vlerësimi i ndikimit ekonomik dhe socio-kulturorë i edicionit 14 të bienales Manifesta](#). Maj, 2023. Hapur së fundmi më 1 korrik 2024.

<sup>10</sup> Përvojat e aplikuesve janë marrë nga tryeza e diskutimit e organizuar nga Instituti GAP në kuadër të projektit Corrwatch, ku morrën pjesë një numër i organizatave aplikuese dhe përfituese të granteve në MKRS.

<sup>11</sup> Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, [Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2014](#). Hapur së fundmi më 5 qershor 2024.

<sup>12</sup> Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, [Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit për vitin 2020. Korrik 2021](#). Hapur së fundmi më 5 qershor 2024.

<sup>13</sup> Zyra e Kryeministrit. [Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021 – 2025](#). Hapur së fundmi më 3 qershor 2024.

<sup>14</sup> Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. [Rregullore nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve](#). Hapur së fundmi më 8 qershor 2024.

Në këtë raport, Instituti GAP ofron një analizë të gjendjes në proceset e ndarjes së subvencioneve nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, duke diskutuar sfidat më të shfaqura si dhe përfitimet që do të sillte digjitalizimi i këtij procesi. Gjetjet e këtij raporti, bazohen edhe në mbledhjen dhe analizën e të dhënave nga 51 thirrje të hapura të MKRS në periudhën 2021-2023, si dhe përvojat e disa nga OJQ-të përfituese ndër vite të fondeve të MKRS-së, që janë marrë nga një tryezë e organizuar nga Instituti GAP në kuadër të projektit Corrwatç.

## Sfidat në procesin e ndarjes së subvencioneve në MKRS dhe digjitalizimi si zgjidhje e tyre

Siç u përmend edhe më lartë, digjitalizimi i procesit të ndarjes së subvencioneve, më konkretisht faza e aplikimit, parashihet edhe me legjislacionin në fuqi<sup>15</sup>, ku aplikuesve ju lejohet të aplikojnë edhe përmes platformave elektronike. Në vitin 2022, MKRS mundësoi që aplikimi për subvencione të bëhej përmes platformës e-Kosova. Një përmirësim që u vërejt në thirrjet e hapura në vitin 2022 ishte në kategorizimin e thirrjeve, ku sipas informatave nga MKRS, u shtuan kritere shtesë. Megjithatë, gjatë procesit të aplikimit u shfaqën shumë probleme teknike, të cilat pamundësuan aplikimin e shumë prej pjesëmarrësve. Një nga sfidat kyçe me të cilën u ballafaquan aplikuesit ishte ngarkesa e sistemit dhe pamundësia për të ngarkuar dokumentet e nevojshme, e si rrjedhojë ato u dorëzuan në format tjetër (me CD ose link në e-mail). Si pasojë e kësaj, MKRS në shkurt të vitit 2022 ndërpreu aplikimin për subvencione në këtë formë, dhe tani është në proces të adresimit të problemeve teknike të shfaqura me sistemin e e-Kosova, dhe rregullimit të aplikimit përmes kësaj platforme<sup>16</sup>. Përveç përmirësimit të aspekteve teknike, MKRS njëkohësisht është duke punuar edhe në aspektin ligjor, ku planifikohet të aprovohet Ligji i ri për art dhe kulturë, si dhe një Rregullore e re për procesin e ndarjes së subvencioneve, që bazohet në atë të MFPT të vitit 2017<sup>17</sup>. Kjo rregullore pritet të përfshijë edhe aspektet teknike të aplikimit në formë elektronike.

Një nga sfidat kyçe që janë vërejtur në thirrjet e hapura në MKRS (33 nga 51 thirrje të hapura gjatë periudhës 2021-2023) është që objektivat ishin sipërfaqësore dhe të pa shoqëruara me detaje në kuptimin se çfarë synohet të arrihet përmes thirrjes. Për më shumë, një sfida që ndërlidhet me arritjen e objektivave të përcaktuara është edhe ndarja e shumave të vogla nga MKRS nëpër thirrje, krahasuar me kërkesat dhe kriteret e thirrjeve. Rrjedhimisht, këto shuma të vogla të ndara mund të ndikojnë në arritje të

<sup>15</sup> Ibid.

<sup>16</sup> Kjo u konfirmua edhe në tryezën e diskutimit të mbajtur nga Instituti GAP me zyrtarët e Zyres së Kryeministrit, të MKRS-së si dhe OJQ-ve aplikuese për subvencione.

<sup>17</sup> Ibid.

përgjysmuar të rezultateve, si dhe objektivave të përcaktuara në thirrje. Ndërsa, specifikimi i qartë i objektivave dhe aktiviteteve për të cilat mund të mbështeten aplikuesit është një metodë më e mirë dhe më e drejtpërdrejtë për të arritur rezultatete të prekshme. Një tjetër sfidë që është vërejtur në thirrjet e hapura dhe përfituesit e këtyre thirrjeve është edhe mos-përputhja e karakteristikave të përfituesve me kriteret e thirrjes. Pra, në disa raste, janë hapur thirrje për kategorinë e krijuesve ose artistëve të rinj, ndërsa përfitues kanë qenë artistë të njohur vendor me përvojë më të gjatë.<sup>18</sup> Megjithatë, në thirrjet e analizuara të periudhës 2021-2023, ka pasur një numër të vogël të thirrjeve ku specifikohet mbështetja e kategorisë së artistëve të rinj. Rrjedhimisht, MKRS do të duhet të krijojë një skemë të veçantë vetëm për mbështetjen e artistëve dhe sportistëve të rinj përmes përcaktimit të kriterëve më të qarta për të dy rastet. Këto sfida do të mund të evitoheshin përmes një platforme elektronike, që do të mundësonte një klasifikim të aplikuesve në fazat fillestare, bazuar në karakteristikat e tyre. Në këtë mënyrë, do të mundësohej një vlerësim më efikas, për shkak të numrit më të vogël të aplikuesve dhe përshtatjes së karakteristikave të tyre me ato të thirrjes. Gjithashtu, përmes klasifikimit fillestar, do të pamundësohej ndarja e subvencioneve për ata që nuk i plotësojnë kriteret, meqë diskualifikohen që në fazat fillestare. Një tjetër përfitim që do të sjellte aplikimi përmes platformës digjitale është edhe ulja e kostove të aplikimit. Siç bëhet e ditur në Raportin e zbatimit të Programit për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Barrës Administrative 2022-2027 dhe Planit të Veprimit 2022-2024, në 20 thirrje aplikojnë mesatarisht 1,500 palë për secilën thirrje.<sup>19</sup> Bazuar në disa supozime të përafërta, ku llogaritet se kosto e printimit dhe skanimit për një aplikim është 3 euro, atëherë sipas llogaritjeve del që në vit shpenzohen gati 100 mijë euro vetëm në këtë aspekt<sup>20</sup>

Në fazën e vlerësimit të aplikacioneve, një ndër problemet që është vërejtur ndër vite është mungesa e transparencës gjatë proceseve të vlerësimit. Për më shumë, nga 51 thirrjet e analizuara është llogaritur se koha e vlerësimit të aplikuesve nga momenti i mbylljes së thirrjeve e deri tek shpallja e fituesve, është 48.8 ditë. Ndërsa, në rregullore është e përcaktuar se kjo duhet të ndodhë për 15 ditë. Përmes digjitalizimit të këtij procesi, do të mundësohej rritja e transparencës në të gjitha fazat e procesit, meqë zyrtarët e komisionit vlerësues nga MKRS do të bënin vlerësimin individualisht në sistem. Për më shumë, sfida me vonesa në vlerësim do të evitohet meqë përmes vlerësimit elektronik të dokumenteve të ngarkuara nga aplikuesit, mundësohet rritje e efikasitetit të vlerësuesve. Një tjetër përfitim i rëndësishëm i digjitalizimit në këtë fazë është edhe zvogëlimi i çfarëdo mundësie për keqpërdorim nga zyrtarët përgjegjës të MKRS, dhe i ndërhyrjeve të mundshme nga jashtë në përzgjedhjen e përfituesve.

Një sfidë tjetër që është përmendur nga vetë aplikuesit<sup>21</sup> për subvencione është edhe kërkesa për dokumentacion origjinal nga MKRS, e që në raste të caktuara i shkakton vështirësi përfituesve në faza të përmbylljes së projekteve, meqë dokumentacioni origjinal kërkohet edhe nga kompanitë

18 Zyra Kombëtare e Auditimit, [Raporti i Auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011](#), qershor 2012. Hapur së fundmi më 5 qershor.

19 Zyra e Kryeministrit. [Raporti i zbatimit të Programit për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Barrës Administrative 2022-2027 dhe Planit të veprimit 2022-2024](#). Hapur së fundmi më 12 korrik 2024.

20 Sipas supozimeve dhe llogaritjeve të Institutit GAP bazuar në deklaratimet e pjesëmarrësve në tryezë.

21 Përvojat e aplikuesve janë marrë nga tryeza e diskutimit e organizuar nga Instituti GAP në kuadër të projektit Corrwatch, ku morrën pjesë një numër i organizatave aplikuese dhe përfituese të granteve në MKRS.



e auditimit të jashtëm. Për më shumë, në raste të caktuara ka pasur edhe humbje të dokumenteve të aplikuesve brenda MKRS-së.<sup>22</sup> Këto parregullsi lehtësisht do të mund të adresoheshin përmes aplikimit online, ku aplikuesit do të ngarkonin dokumentet e tyre origjinale dhe kopje në sistem, duke lejuar qasje të lehtë nga komisioni vlerësues. Gjithashtu, këto dokumente do të mbeteshin në llogarinë e individit apo organizatës aplikuese, e që disa prej tyre do të mund të përdroreshin edhe në aplikime tjera të mundshme. Për më shumë, do të mundësohej krijimi i historikut për secilin aplikues, e që do të lehtësonte punën e komisioneve vlerësuese edhe në të ardhmen. Një parregullsi tjetër që do të zgjidhej nga kjo është mbyllja e avanseve dhe projekteve nga përfituesit. Sipas raporteve të Zyrës Kombëtare të Auditimit, gjatë periudhës 2008-2014, ishin rreth 6 milionë euro avanse/projekte të pa mbyllura nga MKRS. Sipas përvojave të përfituesve të subvencioneve, në raste të caktuara projektet kanë mbetur të pa mbyllura për arsye të vogla teknike, e që mund të jetë mos-sjellja e ndonjë kuponi fiskal apo edhe humbja e tyre. Nëse ky proces do të ishte i digjitalizuar, atëherë mbyllja e avanseve do të ishte shumë më e lehtë për MKRS meqë të gjitha dokumentet e nevojshme dhe faturat do të ngarkoheshin nga përfituesit në sistem.

Në fazën e zbatimit dhe monitorimit të projekteve përfituese, një nga ankesat e përfituesve ishte vonesa në periudhën e nënshkrimit të kontratave, e që ka pasur ndikim në realizim të projekteve. Një ndër shkaqet e këtyre vonesave është fakti që duhet të nënshkruhen fizikisht në zyret e MKRS, e që varen edhe nga prezenca e zyrtarëve përkatës në zyre. Kjo lehtësisht do të mund të realizohej përmes sistemit online me një nënshkrim digjital të të dy palëve, duke rritur efikasitetin dhe mundësuar realizimin e lehtë të projekteve. Një sfidë e vazhdueshme që është përmendur edhe nga zyrtarët e MKRS është monitorimi i zbatimit të projekteve përfituese. Kjo sfidë është përmendur edhe si gjetje në disa prej raporteve të ZKA-së. Sipas zyrtarëve të MKRS, ka mungesë të kapaciteteve njerëzore për monitorim të zbatimit të projekteve në MKRS, duke e bërë të pamundur të ketë monitorim të duhur të projekteve si në aspektin administrativ, ashtu edhe në aspektin e zbatimit të tyre në terren. Nga aspekti i numrit të të punësuarve në departamentet përkatëse në MKRS, dhe numri i subvencioneve të ndara për tre vite, është llogaritur që një zyrtar të monitorojë zbatimin e dhjetë projekteve në vit.<sup>23</sup> MKRS do të mund ta zgjidhte këtë problem përmes digjitalizimit, duke ju mundësuar zbatuesve të projekteve që të gjitha aktivitetet e tyre t'i dokumentojnë me foto/video, dhe t'i ngarkojnë në sistem online. Atëherë, zyrtarët i monitorimit do të mund të qaseshin në sistem dhe të verifikonin të dhënat nga zyra pa pasur nevojë të dalin në terren.

Një tjetër përfitim i rëndësishëm i digjitalizimit të këtyre proceseve është edhe rritja e pjesëmarrësve në thirrjet e hapura. Përmes hapjes së thirrjeve online, ju mundësohet të gjithë individëve/organizatave të interesuara të kenë qasje në këtë informatë. Për më shumë, përmes rritjes së transparencës, rritet edhe besueshmëria e aplikuesve e që mund të ndikojë në rritje të interesimit nga aplikuesit.

<sup>22</sup> Ibid.

<sup>23</sup> Gjithsej gjatë tre viteve të fundit janë dhënë 2,399 subvencione për individ dhe OJQ. Nëse ky numër përpjestohet në tre vite, i bie 799 projekte në vit. E gjithë struktura e MKRS-së në këto departamente është e përbërë nga 77 punonjës.

# Praktikat e shpërndarjes së subvencioneve në vendet e Bashkimit Evropian

Shumë vende të Bashkimit Evropian kanë strategji dhe metoda të qarta të ndarjes së fondeve publike për kulturën, rininë dhe sportin. Në rastin e strategjive, secili shtet ka planifikime të veçanta në atë se si e organizon mbështetjen për veprimtaritë në këto fusha, në cilat dikastere ndahen subvencionet, dhe mënyrat e financimit të tyre. Duke qenë anëtare të BE-së nënkupton një bashkëpunim më të thellë kulturor në mes tyre përmes instrumenteve të BE-së që kanë në dispozicion për kulturën siç është rasti i fondeve disa vjeçare si "Creative Culture".<sup>24</sup> Në aspektin e menaxhimit të projekteve, pra nga hapja e thirrjeve publike për mbështetje për këto veprimtari, e deri te menaxhimi i projekteve nga përfituesit, shtetet e paraqitura më poshtë japin detaje të hollësishme – duke shfaqur transparencë dhe llogaridhënie ndaj qytetarëve. Në Itali, të gjitha thirrjet e hapura për mbështetje bëhen përmes platformës digjitale<sup>25</sup>. Të gjitha thirrjet bazohen në një ligj të caktuar ose strategji kombëtare për kulturën. Megjithatë, jo në të gjitha thirrjet, kriteret e vlerësimit përcaktohen nga vetë Ministria e Kulturës. Më konkretisht, kur është fjala për përgatitje të të rinjëve për tregun e punës, Ministria e Kulturës bazohet edhe në ligjet dhe strategjitë e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale. Pra, në të gjitha thirrjet ka koordinim më të mirë në aspektin e përcaktimit të nevojave për mbështetje të fushave të caktuara dhe përcaktimit të kriterëve të thirrjes.<sup>26</sup> Në këtë sistem, MKRS bën edhe menaxhimin e monitorimin e tërësishëm të procesit të zbatimit të projekteve, pra për të gjithë ciklin e projektit. Gjithashtu, në këtë platformë është edhe një mekanizëm i pyetësorëve për të matur kënaqëshmërinë e përdoruesve të platformës, e që ndihmon për të rritur transparencën e fondeve publike dhe efikasitetin e operimit të sistemit digjital. Metoda e përdorur është përmes publikimit të pyetësorëve në sistem dhe dërgimit të mesazheve të shkruara direkt në platformë nga përdoruesit, të cilat pastaj kategorizohen në llojet e problemeve që hasen nga përdoruesit dhe zgjidhjeve të ofruara nga vetë përfituesit. Ato ndahen në kategori të veçanta siç janë kinemaja dhe projektet audiovizuale, edukimi, hulumtimi dhe kultura, menaxhimi i organizatës dhe menaxhimi i hapësirave arkeologjike.<sup>27</sup>

<sup>24</sup> European Commission. [Creative Culture](#). Hapur së fundmi më 1 korrik 2024.

<sup>25</sup> Për të hyrë në platformë, dhe për të aplikuar kërkohet krijimi i një llogarie në <https://servizionline.cultura.gov.it/>. Hapur së fundmi më 1 korrik 2024.

<sup>26</sup> Ministero Della Cultura, Servizi online, Thirrja e hapur "[40 posita në departamentin general të arkivave](#)". Hapur së fundmi më 1 korrik 2024.

<sup>27</sup> Ministero Della Cultura, [Online services](#). Hapur së fundmi më 1 korrik 2024.

Në Estoni, mbështetja për kulturën, rininë dhe sportin bëhet përmes Fondit për mbështetje për kulturën. Është një Fond i themeluar me ligj dhe përbëhet nga një bord mbikëqyrës prej 11 anëtarëve që zgjedhen nga Qeveria, të cilin e kryeson Ministri/ja e Kulturës. Ky fond mbështet një numër të aktiviteteve kulturore, sportive dhe rinore, në aspektin e kërkimeve shkencore, muzikës, artit, talentëve të rinjë si dhe arritjeve të larta. Vlen të theksohet se 95 përqind e buxhetit të këtij fondi mbushet nga taksat shtetërore të vendosura në produkte si alkoholi dhe duhani, si dhe lojërat e fatit.<sup>28</sup> Në aspektin administrativ, pas aplikimit për subvencionim, fituesit lidhin një kontratë me fondin në të cilën përshkruhen të gjitha aktivitetet dhe afatet e zbatimit të tyre për realizimin e projektit. Sistemi digjital nuk lejon dhënien e bursave, granteve ose çmimeve nëse palët janë vonuar deri në tre muaj në dorëzimin e raportit ose kanë dështuar të dorëzojnë raportin tek fondi. Në rastin e zbatimit të projektit, palët duhet të dorëzojnë raportin një muaj para se të përfundojë zbatimi i projektit, ose më së largu një muaj më pas. Në rast të dështimit të përmbushjes së parimeve të përcaktuara në kontratë, shkeljes së parametrave të përcaktuara në kontratë apo edhe në rast se ka gjetje të shkeljeve të raportimit financiar, Fondi ka të drejtën e revokimit të mjeteve.<sup>29</sup> Në Finlandë, aktivitetet e zhvillimit të kulturës dhe artit përcaktohen nga Ligji për Promovimin e Arteve, Programet e Qeverisë, dhe Strategjia e Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës. Strategjitë janë tre vjeçare, dhe zbatimi i tyre rishikohet çdo vit përmes platformës së vetë-vlerësimit të performancës së programit qeveritar. Përveç mbështetjes për artistë, programi qeveritar bën edhe lidhjen në mes të artistëve dhe tregun e punës duke organizuar panairë, lidhje të marrëveshjeve për mbështetje me shoqata të shkrimtarëve, aktorëve, etj.<sup>30</sup>

Holanda ka gjashtë programe për mbështetje të artit dhe kulturës. Mbështetja organizohet për një numër sektorësh të artit dhe kulturës, ku secili objektivi është i ngushtë për nga fushëveprimi dhe thirrja hapet vetëm për atë kategori – siç është rasti i thirrjeve për tekstshkrues të muzikës, ndarë nga thirrja për tekstshkrues të veprave teatrale, kompozim i veprës së re, mbështetje në produksion, intervenim urban ose ndërkombëtarizim të artit.<sup>31</sup> Megjithatë, në Holandë ekziston edhe një rrjet tjetër i mbështetjes së artistëve por jo në aspektin financiar. DutchCulture ka për qëllim të mbështesë individë dhe organizata që kanë për qëllim të ndërkombëtarizohen përmes Strategjisë për Politika Ndërkombëtare të Kulturës. Këtë e bën duke dhënë këshilla për palët e interesuara, duke gjetur mundësi për artistët në tregje ndërkombëtare si dhe duke organizuar trajnime të ndyshme në këtë aspekt. Ky rrjet mban një komunikim të vazhdueshëm me ambasadat e Holandës për të mundësuar një hapësirë më të madhe të diplomacisë kulturore të Holandës.<sup>32</sup> Për më tepër, falë sistemit të digjitalizuar, DutchCulture ka një databazë që përcjellë në kohë reale performancat ndërkombëtare të artistëve që i mundëson: a) Ministrisë të kuptojë më mirë ndikimin e artit holandez nëpër botë, dhe b) qytetarët mund të kuptojnë më shumë rreth ndikimit të projekteve të financuara nga buxheti shtetëror përmes statistikave të detajuara të publikuara për secilën mbështetje të dhënë nga rrjeti.<sup>33</sup>

28 Fondi Kulturor Estonez. [Raporti vjetor i Fondit Kulturorë Estonez](#), 2022. Hapur së fundmi më 5 korrik 2024.

29 [Fondi Kulturorë Estonez. Termat e përgjishëm për grante](#). Hapur së fundmi më 1 korrik 2024.

30 Qendra e promovimit të artit Finlandez. [Programi i zhvillimit të kushteve të punës për artistët](#), 2022. Hapur së fundmi më 5 korrik 2024.

31 [Fondi i performancës artistike](#). Hapur së fundmi më 1 korrik 2024.

32 [DutchCulture](#). Hapur së fundmi më 1 korrik 2024.

33 Dutch Culture. Databaza e [DutchCulture](#). Hapur së fundmi më 1 korrik 2024.

# Modeli për Kosovën dhe rekomandime

Digjitalizimi i proceseve të dhënies së granteve dhe subvencioneve nga MKRS është një hap i rëndësishëm për të rritur efikasitetin, transparencën dhe menaxhimin e këtyre fondeve. Siç u përmend edhe më lartë, MKRS tanimë është në proces të adresimit të sfidave të shfaqura me sistemin e-Kosova dhe rregullimit të aplikimit për subvencione përmes këtij sistemi. Në këtë mënyrë, përmes përdorimit të një platforme ekzistuese digjitale të shërbimeve publike në Kosovë, lehtësohet procesi për aplikuesit, duke ju krijuar atyre mundësinë e nxjerrjes së dokumenteve të kërkuara (p.sh. çertifikata të ndryshme nga institucionet tjera publike në Kosovë) përmes të njëjtit sistem. Kjo është e rëndësishme të ofrohet nga sistemi meqë përveç lehtësimit të procedurave, mundëson një proces më të thjeshtë dhe më të shpejtë. Gjithashtu, aplikuesit përmes ngarkimit të të dhënave të tyre, do të kenë llogaritë e tyre personale në sistem dhe këto të dhëna duhet të integrohen automatikisht me agjencitë të tjera të të dhënave si: Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) dhe Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK). Në këtë mënyrë, do të ofrohet një pasqyrë e qartë e aplikuesve, duke ndihmuar në identifikimin e projekteve që kanë përmbushur kriteret dhe atyre që kanë dështuar t'i përmbushin. Krijimi i një databaze të projekteve të subvencionuara, si rasti i Holandës, do të ndihmojë në monitorimin dhe dokumentimin e të gjitha projekteve të realizuara me fondet publike. Kjo databazë do të shërbejë si një burim informacioni për thirrje të hapura në të ardhmen por edhe për qytetarët për të parë ndikimin e një pjese të buxhetit të shtetit. Krijimi i qasjes në historikun e pagesave të tatimeve në sistem do të rrisë transparencën dhe llogaridhënien e përfituesve ndaj institucioneve. Një tjetër mundësi që kjo platformë elektronike do të mund të ofronte është integrimi me ato të komunave. Kjo do të krijonte një rrjet të centralizuar për menaxhimin e fondeve publike, duke rritur efikasitetin dhe shmangien e financimit të dyfishtë të projekteve të ngjashme.

Për më shumë, është e rëndësishme që sistemi të ofrojë që i gjithë procesi i ndarjes së subvencioneve të përfshihet aty, duke filluar nga hapja e thirrjes e deri tek përmbyllja e projekteve. Pra, të përfshihen të gjitha fazat si: aplikimi, vlerësimi i aplikuesve, përzgjedhja, monitorimi i realizimit të projekteve dhe përmbyllja e projekteve. Një tjetër çështje e rëndësishme për funksionalizimin e këtij sistemi është edhe reforma ligjore që po bëhet lidhur me këtë aspekt.<sup>34</sup> Përmes funksionalizimit të këtij sistemi, do të krijohet mundësia e planifikimit më të mirë të ndarjes së fondeve. Përmes sistemit, MKRS lehtësisht do të mund të hartonte raporte vjetore përmes të cilave, përveç rritjes së transparencës me qytetarët, do të bënte edhe analizë të situatës së përgjithshme të sektorit të kulturës, rinisë dhe sportit. Një sistem i tillë mund të ndihmojë në analizimin dhe parashikimin e kërkesave për fonde, duke siguruar që alokimi i tyre të bëhet në mënyrë optimale. Për më shumë, kjo do të ndihmonte në shmangien e problemeve me mungesën e fondeve për projekte të caktuara dhe do të siguronte që projektet më të mira të mbështeten në kohën e duhur.

<sup>34</sup> Kjo çështje u diskutua dhe u konfirmua që do të realizohet edhe nga MKRS në tryezën e organizuar nga Instituti GAP me disa zyrtarë të saj dhe OJQ përfituese të subvencioneve.

Një praktikë nga shtetet tjera që do të mund të praktikohet në Kosovë është ajo e Francës në financim të kinematografisë.<sup>35</sup> Sipas kësaj praktike, qeveria bën financimin e kinematografisë, dhe të hyrat nga filmat (shitja e biletave, të drejtave të transmetimit, etj.) dhe nga krijimtaria muzikore (Youtube, Spotify, Instagram, Tiktok) ndahen në mes të autorëve/produksionit përfitues dhe ministrisë përkrahëse. Në këtë mënyrë, MKRS mund të bëhet aksionare në projektet që financon, duke siguruar të drejta për një pjesë të fitimeve nga shitja e biletave, transmetimet, ose platformat digjitale. Kjo do të krijonte një burim të qëndrueshëm të ardhurash që mund të ri-përdoret për të zhvilluar sektorët e artit dhe kulturës. Tek pjesa e monitorimit, zyrtarët e projektit duhet të kenë mundësinë të monitorojnë projektet në kohë reale përmes materialeve (foto/video) të ngarkuara nga përfituesit në sistem. Kjo do të siguronte një monitorim më të lehtë dhe efektiv të zbatimit të projekteve. Për më shumë, mbyllja e projekteve duhet të bëhet digjitale, përmes dorëzimit të raportit përfundimtar të projektit në një afat të caktuar dhe më pas, me lëshimin e një çertifikate që dëshmon përmbylljen me sukses të projektit. Kjo çertifikatë do të ruhet në arkivën e aplikuesit për përdorim në aplikimet e ardhshme. Tutje, të gjitha projektet duhet të jenë pjesë e databazës dhe të kenë një përshkrim të shkurtër. Kjo do të ndihmonte në shmangie të financimit të projekteve të ngjashme në të ardhmen. Një tjetër mundësi që do të mund të ofronte sistemi, e që praktikohet edhe në rastin e Italisë<sup>36</sup>, është ofrimi i pyetësorëve të kënaqshmërisë për aplikuesit dhe përfituesit e fondeve të ministrisë. Përmes përgjigjeve nga përvojat e përdoruesve, MKRS do të ishte më e informuar për ndryshimet/përmirësimet e nevojshme në këto procese. Për më shumë, përshkrimi i saktë i rezultateve të arritura për secilën garë, ekspozitë, turnament ose ngjarje kulturore do të ndihmonte në vlerësimin e ndikimit të fondit të mobilitetit dhe përmirësimin e tij të vazhdueshëm. Tek veprat e artit, rekomandohet se pas çdo blerje të tyre nga artistët, duhet të bëhet katalogimi i tyre me një përshkrim të shkurtër dhe të futen në databazë. Kjo do të ndihmonte në menaxhimin dhe promovimin e artit. Ndërsa tek përfituesit e bursave të MKRS-së, një opsion do të ishte që ata të regjistrohen në një databazë në mënyrë që të ftohen në tryeza shkencore për të dhënë inputet e tyre në dizajnimin e strategjive kombëtare për art, kulturë, sport ose rini.

Në aspektin e diplomacisë kulturore, do të mund të përdorej sistemi i Holandës<sup>37</sup>, e cila ka një databazë të zhvilluar dhe të ndërlidhur me 25 ambasada rreth botës ku bën ndërlidhjen e artistëve dhe komuniteteve artistike lokale, që kultura holandeze të promovohet më mirë dhe të ketë një ndikim më të madh jashtë vendit. Në aspektin e diplomacisë, digjitalizimi do të mund të ndihmonte në ruajtjen e gjithë databazës së trashëgimisë kulturore, kërkimeve shkencore dhe ekspertëve të financuar nga MKRS me qëllim të lobimit nëpër organizata siç është rasti i UNESCO (The United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization) në trashëgimi kulturore.

<sup>35</sup> Qendra Kombëtare Kinematografike Franceze. [Prodhimi i përbashkët i filmit artistik](#). Hapur së fundmi më 12 korrik.

<sup>36</sup> Për të hyrë në platformë, dhe për të aplikuar kërkohet krijimi i një llogarie në <https://servizionline.cultura.gov.it/>  
<sup>37</sup> [DutchCulture](#). Hapur së fundmi më 1 korrik 2024.

# Përfundim

Bazuar në gjetjet e këtij raporti, të cilat mbështeten në një analizë të gjerë të të dhënave, duke përfshirë aspektin ligjor dhe administrativ të ndarjes së subvencioneve në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, analizimin e 51 thirrjeve të hapura për një periudhë tre vjeçare në MKRS, si dhe përvojave të disa përfituesve të këtyre fondeve, vërehet qartë nevoja për digjitalizimin e gjithë procesit të dhënies së subvencioneve. Nga sfidat e shfaqura përgjatë procesit, del se digjitalizimi do të mund të kontribonte në disa aspekte. Fillimisht, do të ngriste efikasitetin e zbatimit të strategjive përmes planifikimit më të mirë të thirrjeve duke u bazuar në objektiva, e më pas edhe kategorizimit më të shpejtë të aplikuesve sipas kriterëve të thirrjeve. Në fazën e aplikimit do të mund të hiqej krejtësisht faza e parë e vlerësimit administrativ të projekteve, duke eliminuar nevojën që komisioni të shpenzonte pesë deri në shtatë ditë pune në këtë proces. Sistemi automatikisht do të mund të kryente këtë funksion përmes interoperabilitetit me regjistra të tjerë shtetëror (përfshirë këtu ATK, ARBK, regjistrin civil, të dhënat e komunave, etj). Në fazën e vlerësimit, përmes digjitalizimit të këtij procesi, do të mundësohej rritja e transparencës dhe e efikasitetit. Më konkretisht, rritja e transparencës dhe ulja e mundësisë për keqpërdorime mundësohet meqë vlerësimi nga secili/a anëtar/e i/e komisionit vlerësues bëhet individualisht në sistem, dhe nuk është i dukshëm për anëtarët e tjerë. Për më shumë, puna e vlerësuesve është më efikase meqë vlerësimi i dokumenteve bëhet në formë elektronike.

Në aspektin e monitorimit, zyrtarët e projektit do të mund të bënin monitorimin online në mënyrë më të shpejtë dhe më efikase. Të gjitha të dhënat e realizimit të projektit si: fotografitë, videot, prononcimet mediale rreth projektit, etj., do të mund të ngarkohen në sistem nga përfituesit e fondeve, pa pasur nevojë që zyrtarët përgjegjës nga MKRS të dalin në terren. Sikurse në sistemin estonez, zyrtarët përgjegjës do të mund të monitoronin zbatimin e projektit në të gjitha fazat dhe për secilin aspekt të jenë të informuar. Gjithashtu, përmes sistemit, do të mund të dërgoheshin njoftime ose rikujtime paraprake tek përfituesit për afatet e mbylljes së projektit dhe specifikave të tjera të mbylljes së projektit. Aspekti i mbylljes së projekteve do të ishte shumë më i lehtë dhe do të ulej mundësia për keqpërdorime të fondeve publike. Kjo ngase faturat do të ngarkoheshin në platformë dhe për çdo faturë që lëshohet në funksion të mbulimit të aktiviteteve të projektit, do të mund të konfirmohej nga ATK. Gjithashtu, do të pamundësohej financimi i dyfishtë i projekteve ose financimi i projekteve të ngjashme nga institucionet e ndryshme publike.

Digjitalizimi do të kontribonte pozitivisht edhe në kohë dhe kosto financiare të aplikuesve. Në aspektin e kohës, një pjesë e dokumenteve veçse do të gjeneroheshin automatikisht nga sistemi, kurse për dokumentet e tjera nuk do të kishte nevojë për printim, nënshkrim, skanim dhe ngarkim në sistem. Siç përmendet në Raportin e Zbatimit të Programit për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Barrës Administrative 2022-2027 dhe Planin e veprimtimit 2022-2024, në 20 thirrje aplikojnë mesatarisht 1,500 palë. Bazuar në disa supozime

të përafërta, ku llogaritet se kosto e printimit dhe skanimit për një aplikim është 3 euro, atëherë sipas llogaritjeve del që në vit shpenzohen gati 100 mijë euro vetëm në këtë aspekt<sup>38</sup>

Një aspekt tjetër i rëndësishëm është edhe kontributi që digjitalizimi do të mund të jepte në aspektin strategjik të sektorit të kulturës, rinisë dhe sportit. Kjo do të mund të realizohej përmes të dhënave të qasshme online të kërkesave për fonde dhe përmes anketave online për të matur opinionin e pjesëmarrësve në aplikime, sikur në rastin e Finlandës. Në këtë mënyrë, MKRS do të kishte një pasqyrë më të qartë të nevojave të komunitetit artistik dhe sfidave të tyre dhe do të mund të orientonte objektivat strategjike të saj bazuar në ato informata.

## Aneks

**Tabela 1.** Buxheti i ndarë për subvencione në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit sipas kategorive të shpenzimeve.

	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
<b>Buxheti total</b>	<b>18,672,808</b>	<b>20,115,174</b>	<b>22,435,278</b>	<b>19,876,704</b>	<b>33,539,942</b>	<b>36,523,904</b>	<b>44,733,726</b>	<b>38,546,389</b>	<b>35,475,708</b>	<b>39,159,109</b>	<b>57,017,861</b>
Subvencionet në fushën e sportit	1,260,418	1,510,418	1,910,418	1,910,418	2,210,418	2,770,418	2,809,655	2,709,655	3,499,655	3,500,000	4,556,550
Subvencionet në fushën e kulturës	2,528,846	2,728,846	2,978,846	1,029,351	3,153,846	3,153,846	3,153,846	3,723,846	4,064,801	4,655,000	7,980,000
Subvencionet në trashëgiminë kulturore	417,286	417,286	417,286	517,286	842,286	842,286	1,303,049	1,138,049	1,334,049	820,000	1,030,000
Subvencionet në fushën e rinisë	700,000	700,000	700,000	800,000	1,000,000	1,400,000	1,750,000	1,680,000	1,771,121	1,241,550	600,000
Paga, mëditje, mallra dhe shpenzime kapitale/komunale	13,766,258	14,758,624	16,428,728	15,619,649	26,333,392	28,357,354	35,717,176	29,294,839	24,806,082	28,942,559	42,851,311
Gjithsej subvencione	4,906,550	5,356,550	6,006,550	4,257,055	7,206,550	8,166,550	9,016,550	9,251,550	10,669,626	10,216,550	14,166,550
<b>Përqindja e realizimit të subvencioneve</b>	<b>88%</b>	<b>99%</b>	<b>100%</b>	<b>99%</b>	<b>98%</b>	<b>89%</b>	<b>91%</b>	<b>91%</b>	<b>92%</b>	<b>89%</b>	<b>99%</b>

**Burimi:** Raportet vjetore financiare 2013-2023, MFPT.

<sup>38</sup> Sipas supozimeve dhe llogaritjeve të Institutit GAP.

## Analizë

Sfidat në dhënien e subvencioneve nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe digitalizimi si instrument për ritjen e efikasitetit

08/2024

---



British Embassy  
Pristina



Group for Legal  
and Political  
Studies

 boogap INSTITUTI GAP  
GAP INSTITUTE

